



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI KOMBËTARI I TERRITORIT

MIRATOHET

KRYETAR I K.K.T-së

Z. EDI RAMA



MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË

Znj. BELINDA BALLUKU



RREGULLORJA E DETAJUAR E

**PLANIT TË DETAJUAR TË ZONËS ME RËNDËSI KOMBËTARE (PDZRK)
MES LAGUNËS SË KARAVASTASË DHE LUMIT SEMAN, E NDRYSHUAR**

Miratur me Vendim të Këshillit Kombëtar të Territorit Nr. 3, Datë 14.10.2020

Hartuar nga

AGJENCIA KOMBËTARE E PLANIFIKIMIT TË TERRITORIT



Përmbajtja

1. Qëllimi dhe Objekti i Rregullores së Planit të Detajuar për Zonën e Rëndësisë Kombëtare mes Lagunës së Karavastasë dhe Lumit Seman	3
1.1. Dispozita të përgjithshme	3
1.2. Qëllimi dhe objekti i Rregullores	3
1.3. Monitorimi i zbatimit të Rregullores	3
2. Përkufizimet dhe shpjegimet e termave e kodeve	4
2.1. Termat.....	4
2.2. Kodet	4
3. Rregullat bazë për distancat.....	4
3.1. Distancat midis ndërtimeve dhe kufirit të pronës	4
3.3. Vija Blu	4
4. Rregullat bazë për mbrojtjen e mjedisit dhe peizazhit.....	5
4.1. Zona e mbrojtur	5
5. Rregullat bazë për infrastrukturën	5
5.1. Infrastruktura rrugore	5
5.2. Infrastruktura të tjera inxhinierike	5
6. Rregullat e zhvillimit për njësi	7



1. Qëllimi dhe Objekti i Rregullores së Planit të Detajuar për Zonën e Rëndësisë Kombëtare mes Lagunës së Karavastasë dhe Lumit Seman

1.1. Dispozita të përgjithshme

1.1.1. Territori subjekt i rregullores

Kjo rregullore zbatohet në sipërfaqen e zonës së trajtuar nga Plani i Detajuar për Zonën me Rëndësi Kombëtare (PDZRK) mes Lagunës së Karavastasë dhe Lumit Seman.

1.1.2. Zbatueshmëria

Rregullorja e PDZRK jep rregulla shtesë, të cilat mbizotërojnë mbi rregullat e përcaktuara nga Plani i Përgjithshëm Vendor i Bashkisë Divjakë, ndërkohë për çdo çështje tjetër që lidhet me zhvillimet në territor dhe nuk trajtohet nga kjo rregullore, zbatohet Rregullorja e PPV-së.

Zbatimi i kësaj rregulloreje është i detyrueshëm për të gjithë personat fizikë e juridikë që ushtrojnë aktivitetin e tyre, kanë pronësi dhe/ose banojnë në territorin subjekt të PDZRK-së, sipas sipërfaqes dhe kufirit të përcaktuar si më sipër.

1.1.3. Ligjshmëria

Kjo rregullore është në përputhje me legjislacionin e planifikimit e të zhvillimit dhe atë sektorial, në fuqi. Zbatueshmëria e saj kufizohet nga këto legjislacione dhe ndryshimet e tyre.

1.2. Qëllimi dhe objekti i Rregullores

1.2.1. Qëllimi

Qëllimi i kësaj rregulloreje është të përcaktojë rregullat e domosdoshme për zbatimin e Planit të Detajuar për Zonën me Rëndësi Kombëtare (PDZRK) mes Lagunës së Karavastasë dhe Lumit Seman.

1.2.2. Objekti

Objekt i kësaj rregulloreje janë kushtet e zhvillimit sipas Rregullores së Planifikimit të Territorit (miratuar me VKM Nr. 686, datë 22.11.2017) dhe Rregullores së Zhvillimit të Territorit (miratuar me VKM Nr. 408, datë 13.05.2015, e ndryshuar), rregullat e përdorimit të tokës për çdo njësi, si dhe rregulla të tjera në përputhje me akte të tjera ligjore që veprojnë në zonë.

1.3. Monitorimi i zbatimit të Rregullores

Monitorimi, referuar nenit 10, pika 2, të VKM Nr. 686, datë 22.11.2017, procesi i zbatimit të dokumenteve të planifikimit monitorohet nga Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit në bashkërendimin me autoritetet përgjegjëse për planifikimin. Në vijim, AKPT monitoriton zbatimin e kësaj rregulloreje.

1.3.1. Rishikimi i rregullores

- a) Rregullorja është objekt i rishqyrtimit të plotë apo të pjesshëm në kuadër të rishqyrtimit dhe rishikimit të dokumentit të PDZRK-së. Ajo rishikohet e miratohet sipas legjislacionit të posaçëm në fuqi. Procesi për shqyrtimin e plotë apo të pjesshëm të rregullores dhe të të gjithë dokumentacionit të PDZRK-së fillonme kërkesë të autoriteteve publike apo subjekteve private që ushtrojnë aktivitetin në territorin subjekt planifikimi, sipas Ligjit Nr. 107/2014, “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar, ose sipas përcaktimeve të reja ligjore në momentin e ndryshimit të saj.
- b) Rishikimi i PDZRK dhe Rregullores në zbatim të tij do të ndjekin përcaktimet e VKM Nr. 686, datë 22.11.2017 “Për miratimin e Rregullores së Planifikimit të Territorit”.



2. Përkufizimet dhe shpjegimet e termave e kodeve

2.1. Termat

Termit e përdorur në këtë rregullore kanë të njëjtin kuptim me ata të përcaktuar në Ligjin Nr. 107/2014, “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar, dhe akteve nënligjore në zbatim të tij, si dhe me ato të përcaktuara në ligjet e posaçme në fuqi.

2.2. Kodet

Në përputhje me përcaktimet e Rregullores së Planifikimit të Territorit, territori subjekt planifikimi është ndarë në njësi strukturore. Për secilën njësi janë përcaktuar kushtet e zhvillimit në përputhje me Rregulloren e Planifikimit dhe atë të Zhvillimit të Territorit.

2.2.1. Kodet për Përdorimin e Tokës të përdorura në këtë rregullore janë të njëjta me ato të Shtojcës I të VKM Nr. 686, datë 22.11.2017 “Për Miratimin e Rregullores së Planifikimit të Territorit”, e ndryshuar.

2.2.2. Kodet për njësitë strukturore janë formuar në bazë të Shtojcës II të VKM Nr. 686, datë 22.11.2017 “Për Miratimin e Rregullores së Planifikimit të Territorit”, e ndryshuar.

2.2.3. Kodet për sistemin rrugor janë përcaktuar sipas nenit 2 të Kodit Rrugor, i miratuar me Ligjin Nr. 8378, datë 22.07.1998, “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.

3. Rregullat bazë për distancat

3.1. Distancat midis ndërtimeve dhe kufirit të pronës

Ruajtja e largësisë midis ndërtimeve dhe kufirit të pronës kryhet sipas përcaktimeve të VKM Nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit”, e ndryshuar si dhe VKM Nr. 283, datë 01.04.2015 “Për përcaktimin e tipave, rregullave, kriterëve dhe procedurave për ndërtimin e objekteve për prodhimin, ruajtjen dhe përpunimin e produkteve bujqësore dhe blegtorale, në tokë bujqësore”, e ndryshuar.

3.2. Distancat e ndërtimeve nga trupi i rrugës

Ruajtja e largësisë midis ndërtimeve dhe trupit të rrugës kryhet sipas përcaktimeve të VKM Nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit”, e ndryshuar dhe VKM Nr.153, datë 07.04.2000 “Për miratimin e Rregullores së Zbatimit të Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë” e ndryshuar.

3.3. Vija Blu

Vija Blu është e përcaktuar në përputhje me legjislacionin sektorial, dhe përcaktohet saktësisht në hartën e Njërive Strukturore dhe Zonave të Kufizimit të Zhvillimit (U-04), ku dallohet qartë mbivendosja e njërive me zonat mbrojtëse të trupave ujore.

Laguna ka një zonë mbrojtëse me shtrirje 100-200 m nga trupi ujqor, siç pasqyrohet në hartën U-04.

Kanalet e kategorisë I kanë një zonë mbrojtëse jo më të vogël se 8 m nga secila anë e trupit ujqor (vija e takimit të sipërfaqes së tokës me skarpatën e kanalit kullues ose vija e takimit të skarpatës së jashtme të bankinës së kanalit ujitës me sipërfaqen e tokës), siç pasqyrohet në hartën U-04.

Kanalet e kategorisë II dhe të III kanë një zonë mbrojtëse jo më të vogël se 4 m nga secila anë, siç pasqyrohet në hartën U-04.



Emisari i Myzeqesë, gjithashtu edhe shtrati i vjetër i Lumit Seman (lumi i vdekur), ka një zonë mbrojtëse që varion nga 28-40 m nga secila anë e trupit ujqor, siç pasqyrohet në hartën U-04.

Lumi Seman ka një zonë mbrojtëse jo më të vogël se 100 m, siç pasqyrohet në hartën U-04.

4. Rregullat bazë për mbrojtjen e mjedisit dhe peizazhit

4.1. Zona e mbrojtur

Sipas ligjit Nr. 81/2017 për Zonat e Mbrojtura, kemi një bashkim të nënzonës së përdorimit të qendrueshëm me atë të përdorimit tradicional, në nëzonën e përdorimit tradicional dhe të qendrueshëm. Në të janë të ndaluara, krahas atyre që parashikon Plani i Menaxhimit të PKDK, edhe:

- Ndryshimi i gjendjes natyrore të rezervave ujore, burimeve, liqeneve dhe sistemeve të zonave të lagura;
- Depozitimi i kimikateve;
- Lëvizja dhe parkimi i automjeteve jashtë rrugëve publike dhe vendeve të përcaktuara për parkim;
- Mbledhja intensive e bimeve, mineraleve, gurëve, gjetjeve paleontologjike;
- Vendosja e stendave, tabelave, reklamave, shenjave dhe posterave, me përjashtim të atyre që japin informacion për objektivat e mbrojtjes së rezervatit;
- Kampingjet dhe ndezja e zjarreve jashtë pikave dhe shtigjeve të caktuara.

Veç Ligjit, në njësitë, pjesë e zonës së mbrojtur të Parkut Kombëtar Divjakë-Karavasta, në bazë të Planit të Menaxhimit të Zonës, veprojnë edhe rregullat e mëposhtme:

Për njësitë, pjesë të Nënzonës së Përdorimit të Qendrueshëm (ZPQ), ndalohen:

- introduktimi i peshqve dhe specieve ujore jo autoktone;
- akuakultura intensive;
- shqetësimi i zonës së folezimit të pelikanit në distancë prej 300m;
- peshkimi me mjete motorrike;
- ndërtimi i hapësirave të banimit.

Për njësitë, pjesë të Nënzonës së Përdorimit Tradicional (ZPT), ndalohet:

- ndezja e zjarreve dhe hedhja e mbetjeve të ngurta në tokat bujqësore;
- heqja e dheut dhe hapja e një sistemi të ri kullimi;
- mbjellja e bimëve jo autoktone.

Kufizimet e mësipërme si dhe zonimi i zonës së mbrojtur mund të ndryshojnë në rast rishikimi të dokumentit të Planit të Menaxhimit të Parkut Kombëtar Divjakë-Karavasta.

5. Rregullat bazë për infrastrukturën

5.1. Infrastruktura rrugore

PDZRK parashikon rrugë të kategorisë F në zonë

Për zbatimin e infrastrukturës rrugore në zonë vlejnë rregullat e Rregullores së Planit të Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Divjakë, ne përputhje me orientimet e pikës 1.1.2 më sipër.

5.2. Infrastruktura të tjera inxhinierike


Infrastruktura energjitike për aktivitetet e lejuara lidhet me rrjetin ekzistues, paraqitur edhe në dokumentin e PPV Divjakë. Për arsye mbrojtje të biodiversitetit në PKDK, rrjeti duhet të shtrihet nëntokë në çdo rast, duke konsideruar veprimtarinë bujqësore në terren dhe duke ndjekur kufijtë e parcelave bujqësore.

Për çdo ndërhyrje tjetër në territor lidhur me infrastrukturën, veprojnë rregullat e përgjithshme të përcaktuara në **Rregulloren e Planit të Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Divjakë**.



6. Rregullat e zhvillimit për njësi

DJ_B_EB_1 (Divjakë_Bujqësi_Ekonomi Bujqësore_Nr.1)




	Përshkrim	Njësi e orientuar drejt zhvillimit të ekonomisë bujqësore.
1	Kodi i njësisë	DJ_B_EB_1
2	Sipërfaqe	405 Ha
3	Nr. banorësh	-
4	Dendësi popullsie	-
5	Sistemi	B – Bujqësor
6	Kategori përdorimi toke	EB – Ekonomi Bujqësore
7	Përqindja e përdorimit	100%
8	Përdorime të tjera të lejuara	B – Tokë Bujqësore IB – Infrastrukturë Bujqësore INT – Infrastrukturë Transporti IUK – Infrastrukturë Ujësjellës-Kanalizime N – Tokë Natyrore
9	Përdorime të ndaluara	Të gjitha kategoritë dhe nënkategoritë e pacituara më sipër
10	Përdorime të kushtëzuara	-
11	Nënkategori përdorimi toke	EB1 – Struktura në Funksion të Bujqësisë EB2 – Struktura në Funksion të Blegtorisë <i>Të lejuara:</i> IB3 – Infrastrukturë Vaditje dhe Kullimi INT1 – Infrastrukturë Rrugore IUK1 – Ujësjellësi B1 – Kultura të Përherëshme B2 – Kultura të Përkohshme

12	Intensiteti i ndërtimit (I)	0.005
13	KSHT	0.25%
14	KSHR	1%
15	KSHP	-
16	Lartësia (kate)	Sipas llojit të strukturës / projektit teknik
17	Lartësia (metra)	Sipas llojit të structures / projektit teknik
18	Treguesit e distancave	Sipas pikës 3 të kësaj rregullore
19	Gjelbërim/banor	-
20	Nr. vendparkimesh	-
21	Mënyra e ndërhyrjes	-
22	Tipologjia hapësinore	-
23	Kufizime ligjore	Njësia bën pjesë ne Parkun Kombëtar Divjakë-Karavasta. Për ushtrimin e çdo aktiviteti në të vepron Ligji 18/2017 për Zonat e Mbrojtura dhe Plani i Menaxhimit për Zonën e Mbrojtur të PKDK.
24	Kushte të tjera	Për çdo ndërhyrje në territor, zbatohet distanca mbrojtëse nga trupat ujorë, sipas pikës 3.2 të kësaj rregullore.




DJ_B_EB_2 (Divjakë_Bujqësi_Ekonomi_Bujqësore_Nr.2)




	Përshkrim	Njësi e orientuar drejt zhvillimit të akuakulturës.
1	Kodi i njësisë	DJ_B_EB_2
2	Sipërfaqe	1.3 Ha
3	Nr. banorësh	-
4	Dendësi popullore	-
5	Sistemi	B – Bujqësor
6	Kategori përdorimi toke	EB – Ekonomi Bujqësore
7	Përqindja e përdorimit	100%
8	Përdorime të tjera të lejuara	IB – Infrastrukturë Bujqësore INT – Infrastrukturë Transporti IUK – Infrastrukturë Ujësjetës-Kanalizime IMB – Infrastrukturë Menaxhimi Mbetjesh S – Shërbime
9	Përdorime të ndaluara	Të gjitha kategoritë dhe nënkategoritë e pacituara më sipër
10	Përdorime të kushtëzuara	-
11	Nënkategori përdorimi toke	EB2 – Struktura në Funksion të Blegtorisë <i>Të lejuara:</i> IB3 – Infrastrukturë Vadtje dhe Kullimi INT1 – Infrastrukturë Rugore IUK1 – Ujësjetës IUK2 – Kanalizime IEN1 – Elektrike IMB2 – Depozitim mbetjesh S2 – Shërbime Tregtare dhe Biznesi
12	Intensiteti i ndërtimit (I)	2
13	KSHT	100%




14	KSHR	Sipas projektit teknik
15	KSHP	-
16	Lartësia (kate)	2
17	Lartësia (metra)	7
18	Treguesit e distancave	Sipas pikës 3 të kësaj rregullore.
19	Gjelbërim/banor	-
20	Nr. vendparkimesh	-
21	Mënyra e ndërhyrjes	Zhvillim
22	Tipologjia hapësinore	-
23	Kufizime ligjore	Njësia bën pjesë ne Parkun Kombëtar Divjakë-Karavasta. Për ushtrimin e çdo aktiviteti në të vepron Ligji 18/2017 për Zonat e Mbrojtura dhe Plani i Menaxhimit për Zonën e Mbrojtur të PKDK.
24	Kushte të tjera	Për çdo ndërhyrje në territor, zbatohet distanca mbrojtëse nga trupat ujorë, sipas pikës 3.2 të kësaj rregullore. Kushtet e zhvillimit reflektojnë nevojat teknike për llojin specific të strukturës në shërbim të akuaponisë.



DJ_N_NAR_1 (Divjakë_Natyrë_Natyrë dhe Argëtim_Nr.1)




	Përshkrim	Njësi që përfshin vendbanimin ekzistues të Adriatikut.
1	Kodi i njësisë	DJ_N_NAR_1
2	Sipërfaqe	46 Ha
3	Nr. banorësh	480
4	Dendësi popullsie	10.4 ban/ha
5	Sistemi	N – Natyror
6	Kategori përdorimi toke	NAR – Natyrë dhe Argëtim
7	Përqindja e përdorimit	Përcaktohet në planin e detajuar për njësinë
8	Përdorime të tjera të lejuara	A – Banim S – Shërbime AR – Aktivitete Shoqërore dhe Argëtimi INT – Infrastrukturë Transporti IUK – Infrastrukturë Ujësjellës Kanalizime IMB – Infrastrukturë Menaxhimi Mbetjesh
9	Përdorime të ndaluara	-
10	Përdorime të kushtëzuara	-
11	Nënkategori përdorimi toke	NAR4 – Ekoturizëm, që përfshin shërbime akomoduese dhe shërbime rekreative. <i>Të lejuara:</i> A2 – Banim dhe Shërbime S1 – Shërbime Akomodimi dhe Argëtimi AR1 – Hapësira Publike INT1 – Infrastrukturë Rrugore IEN1 – Elektrike IUK1 – Ujësjellës IUK2 – Kanalizime IMB2 – Depozitim mbetjesh



12	Intensiteti i ndërtimit (I)	Përcaktohet në planin e detajuar për njësinë
13	KSHT	Përcaktohet në planin e detajuar për njësinë
14	KSHR	Përcaktohet në planin e detajuar për njësinë
15	KSHP	Përcaktohet në planin e detajuar për njësinë
16	Lartësia (kate)	Përcaktohet në planin e detajuar për njësinë
17	Lartësia (metra)	Përcaktohet në planin e detajuar për njësinë
18	Treguesit e distancave	Përcaktohet në planin e detajuar për njësinë
19	Gjelbërim/banor	Përcaktohet në planin e detajuar për njësinë
20	Nr. vendparkimesh	Përcaktohet në planin e detajuar për njësinë
21	Mënyra e ndërhyrjes	Përcaktohet në planin e detajuar për njësinë
22	Tipologjia hapësinore	Përcaktohet në planin e detajuar për njësinë
23	Kufizime ligjore	Njësia bën pjesë ne Parkun Kombëtar Divjakë-Karavasta. Për ushtrimin e çdo aktiviteti në të vepron Ligji 18/2017 për Zonat e Mbrojtura dhe Plani i Menaxhimit për Zonën e Mbrojtur të PKDK.
24	Kushte të tjera	Zhvillimi i njësisë duhet të përcaktohet nga një plan i detajuar i posaçëm.



DJ_B_B_1 (Divjakë_Bujqësi_Bujqësi_Nr.1)




	Përshkrim	Njësi me karakter bujqësor
1	Kodi i njësisë	DJ_B_B_1
2	Sipërfaqe	326 Ha
3	Nr. banorësh	-
4	Dendësi popullsie	-
5	Sistemi	B – Bujqësor
6	Kategori përdorimi toke	B – Tokë Bujqësore
7	Përqindja e përdorimit	100%
8	Përdorime të tjera të lejuara	IB – Infrastrukturë Bujqësore INT – Infrastrukturë Transporti EB – Ekonomi Bujqësore
9	Përdorime të ndaluara	Të gjitha kategoritë dhe nënkategoritë e pacituara më sipër
10	Përdorime të kushtëzuara	-
11	Nënkategori përdorimi toke	B1 – Kultura të përhershme B2 – Kultura të përkohshme <i>Të lejuara:</i> IB3 – Infrastrukturë Vadtje dhe Kullimi INT1 – Infrastrukturë Rrugore EB1 – Struktura në Funkcion të Bujqësisë EB2 – Struktura në Funkcion të Blegtorisë
12	Intensiteti i ndëimit (I)	-
13	KSHT	-
14	KSHR	1.7%
15	KSHP	-
16	Lartësia (kate)	-

16	Lartësia (kate)	-
17	Lartësia (metra)	-
18	Treguesit e distancave	Sipas pikës 3 të kësaj rregullore.
19	Gjelbërim/banor	-
20	Nr. vendparkimesh	-
21	Mënyra e ndërhyrjes	-
22	Tipologjia hapësinore	-
23	Kufizime ligjore	Njësia bën pjesë ne Parkun Kombëtar Divjakë-Karavasta. Për ushtrimin e çdo aktiviteti në të vepron Ligji 18/2017 për Zonat e Mbrojtura dhe Plani i Menaxhimit për Zonën e Mbrojtur të PKDK.
24	Kushte të tjera	Për çdo ndërhyrje në territor, zbatohet distanca mbrojtëse nga trupat ujorë, sipas pikës 3.2 të kësaj rregullore.



DJ B B 2 (Divjakë Bujësi Bujësi Nr.2)




Përshkrim	Njësi me karakter bujqësor	DJ B B 2
Kodi i njësisë		242.5 Ha
Sipërfaqe		
Nr. banorësh		
Dendësi popullore		
Sistemi	B - Bujqësor	
Kategori përdorimi toke	B - Tokë Bujqësore	100%
Përqindja e përdorimit		
Përdorime të tjera të lejuara	IB - Infrastruktura Bujqësore INT - Infrastruktura Transporti	
Përdorime të ndaluara	Të gjitha kategoritë dhe nënkategoritë e pacituara më sipër	
Përdorime të kushtëzuara		
Nënkategori përdorimi toke	B1 - Kultura të përtheshme B2 - Kultura të përtheshme	<i>Të lejuara:</i> IB3 - Infrastruktura Vadiqe dhe Kullimi INT1 - Infrastruktura Rrugore
Intensiteti i ndërrimit (I)		
KSHT		
KSHR	1%	
KSHP		
Lartësia (kate)		
Lartësia (metra)		
Treguesit e distancave	Sipas pikës 3 të kësaj rregullore.	



19	Gjelbërim/banor	-
20	Nr. vendparkimesh	-
21	Mënyra e ndërhyrjes	-
22	Tipologjia hapësinore	-
23	Kufizime ligjore	Njësia bën pjesë ne Parkun Kombëtar Divjakë-Karavasta. Për ushtrimin e çdo aktiviteti në të vepron Ligji 18/2017 për Zonat e Mbrojtura dhe Plani i Menaxhimit për Zonën e Mbrojtur të PKDK.
24	Kushte të tjera	Për çdo ndërhyrje në territor, zbatohet distanca mbrojtëse nga trupat ujorë, sipas pikës 3.2 të kësaj rregullore.



DJ_B_IB_1 (Divjakë_Bujqësi_Infrastrukturë Bujqësore_Nr.1)




	Përshkrim	Njësi që përfshin Emisarin e Myzeqesë dhe brezin e tij mbrojtës
1	Kodi i njësisë	DJ_B_IB_1
2	Sipërfaqe	41 Ha
3	Nr. banorësh	-
4	Dendësi popullsie	-
5	Sistemi	B - Bujqësor
6	Kategori përdorimi toke	IB - Infrastrukturë Bujqësore
7	Përqindja e përdorimit	100%
8	Përdorime të tjera të lejuara	
9	Përdorime të ndaluara	Të gjitha kategoritë dhe nënkategoritë e pacituara më sipër
10	Përdorime të kushtëzuara	-
11	Nënkategori përdorimi toke	IB3 - Infrastrukturë Vaditje dhe Kullimi
12	Intensiteti i ndërrimit (I)	-
13	KSHT	-
14	KSHR	-
15	KSHP	-
16	Lartësia (kate)	-
17	Lartësia (metra)	-
18	Treguesit e distancave	-
19	Gjelbërim/banor	-
20	Nr. vendparkimesh	-
21	Mënyra e ndërhyrjes	-
22	Tipologjia hapësinore	-

23	Kufizime ligjore	Njësia bën pjesë ne Parkun Kombëtar Divjakë-Karavasta. Për ushtrimin e çdo aktiviteti në të vepron Ligji 18/2017 për Zonat e Mbrojtura dhe Plani i Menaxhimit për Zonën e Mbrojtur të PKDK.
24	Kushte të tjera	-



DJ_B_B_3 (Divjakë_Bujqësi_Bujqësi_Nr.3)




	Përshkrim	Njësi me karakter bujqësor.
1	Kodi i njësisë	DJ_B_B_3
2	Sipërfaqe	522,5 ha
3	Nr. banorësh	-
4	Dendësi popullsie	-
5	Sistemi	B – Bujqësor
6	Kategori përdorimi toke	B – Tokë Bujqësore
7	Përqindja e përdorimit	100%
8	Përdorime të tjera të lejuara	IB – Infrastrukturë Bujqësore INT – Infrastrukturë Transporti IUK – Infrastrukturë Ujësjellës-Kanalizime EB – Ekonomi Bujqësore
9	Përdorime të ndaluara	Të gjitha kategoritë dhe nënkategoritë e pacituara më sipër
10	Përdorime të kushtëzuara	-
11	Nënkategori përdorimi toke	B1 – Kultura të përhershme B2 – Kultura të përkohshme <u>Të lejuara:</u> IB3 – Infrastrukturë Vadtje dhe Kullimi INT1 – Infrastrukturë Rrugore IUK1 – Ujësjellës IUK2 – Kanalizime EB1 – Struktura në Funkcion të Bujqësisë EB2 – Struktura në Funkcion të Blegtorisë
12	Intensiteti i ndërimit (I)	-
13	KSHT	-
14	KSHR	0.6%



14	KSHR	0.6%
15	KSHP	-
16	Lartësia (kate)	-
17	Lartësia (metra)	-
18	Treguesit e distancave	Sipas pikës 3 të kësaj rregullore.
19	Gjelbërim/banor	-
20	Nr. vendparkimesh	-
21	Mënyra e ndërhyrjes	-
22	Tipologjia hapësinore	-
23	Kufizime ligjore	Njësia bën pjesë ne Parkun Kombëtar Divjakë-Karavasta. Për ushtrimin e çdo aktiviteti në të vepron Ligji 18/2017 për Zonat e Mbrojtura dhe Plani i Menaxhimit për Zonën e Mbrojtur të PKDK.
24	Kushte të tjera	Për çdo ndërhyrje në territor, zbatohet distanca mbrojtëse nga trupat ujorë, sipas pikës 3.2 të kësaj rregullore.



DJ_N_N_1 (Divjakë_Natyrë_Nr.1)




	Përshkrim	Njësi me karakter natyror.
1	Kodi i njësisë	DJ_N_N_1
2	Sipërfaqe	51,5 ha
3	Nr. banorësh	-
4	Dendësi popullesie	-
5	Sistemi	N - Natyror
6	Kategori përdorimi toke	N- Tokë Natyrore
7	Përqindja e përdorimit	100%
8	Përdorime të tjera të lejuara	-
9	Përdorime të ndaluara	Të gjitha kategoritë dhe nënkategoritë e pacituara më sipër
10	Përdorime të kushtëzuara	-
11	Nënkategori përdorimi toke	-
12	Intensiteti i ndërrimit (I)	-
13	KSHT	-
14	KSHR	-
15	KSHP	-
16	Lartësia (kate)	-
17	Lartësia (metra)	-
18	Treguesit e distancave	-
19	Gjelbërim/banor	-
20	Nr. vendparkimesh	-
21	Mënyra e ndërhyrjes	-
22	Tipologjia hapësinore	-

23	Kufizime ligjore	Njësia bën pjesë ne Parkun Kombëtar Divjakë-Karavasta. Për ushtrimin e çdo aktiviteti në të vepron Ligji 18/2017 për Zonat e Mbrojtura dhe Plani i Menaxhimit për Zonën e Mbrojtur të PKDK.
24	Kushte të tjera	-



DJ_B_EB_3 (Divjakë_Bujqësi_Ekonomi Bujqësore_Nr.3)




	Përshkrim	Njësi me e orientuar drejt zhvillimit të ekonomisë bujqësore.
1	Kodi i njësisë	DJ_B_EB_3
2	Sipërfaqe	10.7 Ha
3	Nr. banorësh	-
4	Dendësi popullsie	-
5	Sistemi	B - Bujqësor
6	Kategori përdorimi toke	EB - Ekonomi Bujqësore IB - Infrastrukturë Bujqësore
	Përqindja e përdorimit	30% EB ; 70% IB.
8	Përdorime të tjera të lejuara	INT - Infrastrukturë Transporti IUK - Infrastrukturë Ujësjiellës-Kanalizime Shërbime në funksion të aktivitetit ekonomik bujqësor.
9	Përdorime të ndaluara	Të gjitha kategoritë dhe nënkategoritë e pacituara më sipër
10	Përdorime të kushtëzuara	-
11	Nënkategori përdorimi toke	EB1 - Struktura në Funksion të Bujqësisë IB3 - Infrastrukturë vaditje dhe kullimi <i>Të lejuara</i> INT1 - Infrastrukturë rrugore – IUK1 - Ujësjiellës IUK2 – Kanalizime
12	Intensiteti i ndërrimit (I)	0.2
13	KSHT	8%
14	KSHR	5%
15	KSHP	-
16	Lartësia (kate)	2



17	Lartësia (metra)	7
18	Treguesit e distancave	Sipas pikës 3 të kësaj rregullore.
19	Gjelbërim/banor	-
20	Nr. vendparkimesh	75
21	Mënyra e ndërhyrjes	Zhvillim
22	Tipologjia hapësinore	-
23	Kufizime ligjore	-
24	Kushte të tjera	Për çdo ndërhyrje në territor, zbatohet distanca mbrojtëse nga trupat ujorë, sipas pikës 3.2 të kësaj rregullore.



DJ_B_EB_4 (Divjakë_Bujqësi_Ekonomi Bujqësore_Nr.4)



	Përshkrim	Njësi me karakter bujqësor dhe e orientuar drejt zhvillimit të agroturizmit.
1	Kodi i njësisë	DJ_B_EB_4
2	Sipërfaqe	402.76 Ha
3	Nr. banorësh	-
4	Dendësi popullesie	-
5	Sistemi	B - Bujqësor
6	Kategori përdorimi toke	EB – Ekonomi Bujqësore B - Tokë Bujqësore
7	Përqindja e përdorimit	EB 50% B 50%
8	Përdorime të tjera të lejuara	IB - Infrastrukturë Bujqësore INT - Infrastrukturë Transporti IUK – Infrastrukturë Ujësjiellës Kanalizime IEN – Infrastrukturë Energjitike
9	Përdorime të ndaluara	Të gjitha kategoritë dhe nënkategoritë e pacituara më sipër
10	Përdorime të kushtëzuara	-
11	Nënkategori përdorimi toke	EB1 – Struktura në funksion të bujqësisë EB3 – Agroturizëm B1 - Kultura të përherëshme B2 - Kultura të përkohshme <i>Të lejuara:</i> IB3 - Infrastrukturë Vaditje dhe Kullimi INT1 - Infrastrukturë Rrugore IUK1 - Ujësjiellës IUK2 – Kanalizime IEN1 - Elektrike

12	Intensiteti i ndërrimit (I)	0.0062
13	KSHT	0.62%
14	KSHR	2.42%
15	KSHP	-
16	Lartësia (kate)	Sipas llojit të strukturës/projektit teknik
17	Lartësia (metra)	Sipas llojit të strukturës/projektit teknik
18	Treguesit e distancave	Sipas pikës 3 të kësaj rregullore.
19	Gjelbërim/banor	-
20	Nr. vendparkimesh	Sipas llojit të strukturës/projektit teknik
21	Mënyra e ndërhyrjes	Zhvillim
22	Tipologjia hapësinore	-
23	Kufizime ligjore	-
24	Kushte të tjera	Për çdo ndërhyrje në territor, zbatohet distanca mbrojtëse nga trupat ujorë, sipas pikës 3.2 të kësaj rregullore.

